



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 3489 Prot.

Tiranë, më 10/06/2020

URDHËR

Nr. 164, datë 10.06.2020

**“PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURAT E PLOTËSIMIT TË VENDEVE
VAKANTE SI NOTER”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 11, pika 5 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter, sipas përcaktimeve të këtij urdhëri.
2. Çdo vend vakant i krijuar plotësohet sipas radhës së mëposhtme:
 - a) nëpërmjet transferimit të një noteri që ka kërkuar transferim në këtë pozicion;
 - b) nëpërmjet dhënies së licencës së noterit një zëvendësnoteri që ka shprehur interesin për vendin e ri vakant;
3. Ministria e Drejtësisë kryen evidentimin e vendeve vakante si noter dhe përgatit listën përkatëse sipas bashkive ku janë evidentuar vakancat.
4. Shpallja e çdo vendi vakant kryhet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të ministrisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, jo më vonë se 30 ditë nga data e krijimit të pozicionit, shoqëruar me dokumentacionin që duhet ti bashkëlidhet kërkesës.
5. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, organizon punën për regjistrimin e kërkesave dhe informon të interesuarit lidhur me afatin për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm që i bashkëlidhet kërkesës.



6. Noteri paraqet kërkesë me shkrim pranë Ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë për transferimin e veprimtarisë noteriale brenda 30 ditëve nga publikimi i vendeve vakante në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, faqen zyrtare të Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, duke përcaktuar dhe preferencën gjeografike për vendin vakant për të cilin shpreh interesin.
7. Drejtoria e Përgjithshme Rregullore e Çështjeve të Drejtësisë brenda 10 ditëve kryen verifikimin e kushteve ligjore të noterëve që kërkojnë transferim dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit 30 ditor për paraqitjen e kërkesës, harton listën e cila duhet të përmbajë emrat e noterëve që kanë shprehur interesin për transferim dhe plotësojnë kriteret, si dhe bashkitë në të cilat dëshirojnë të transferohen. Lista duhet të jetë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.
8. Noteri i cili paraqet kërkesë për transferimin e veprimtarisë noteriale duhet të ketë ushtruar për jo më pak se 5 vjet veprimtarinë në juridiksionin ekzistues dhe me kusht që në momentin e transferimit të jetë jo më shumë se 65 vjeç dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij.
9. Në rastin e kandidatëve që aplikojnë për transferim në të njëjtën degë vendore dhe që plotësojnë kriteret ligjore, fitues shpallet kandidati me vjetërsi më të madhe në profesion.
10. Në rastin e kandidatëve që aplikojnë për transferim në të njëjtën degë vendore, që plotësojnë kriteret ligjore dhe që kanë të njëjtën vjetërsi pune në profesion, fitues shpallet kandidati vendbanimi i të cilit ndodhet më pranë bashkisë ku është evidentuar vendi vakant.
11. Ministri i Drejtësisë urdhëron transferimin e veprimtarisë së noterit brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit, nëse plotësohen kriteret për transferim, të përcaktuara në ligjin nr. 110/2018 "Për noterinë".
12. Noterët të cilët nuk përmbushin kushtet dhe kriteret ligjore për transferimin e veprimtarisë noteriale, informohen në adresën e tyre postare nga Ministria e Drejtësisë mbi arsyet e refuzimit.
13. Vendi vakant që nuk mund të plotësohet nëpërmjet transferimit për shkak të mungesës së kërkesave apo mosplotësimit të kushteve ligjore, plotësohet nëpërmjet dhënies së licencës një zëvendësnoteri.
14. Zëvendësnoteri paraqet kërkesë me shkrim pranë Ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë brenda 30 ditëve nga publikimi i vendeve vakante në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, duke përcaktuar dhe preferencën gjeografike për vendin vakant për të cilin shpreh interesin.
15. Drejtoria e Përgjithshme Rregullore e Çështjeve të Drejtësisë brenda 10 ditëve kryen verifikimin e kushteve ligjore të zëvendësnoterëve që shprehin interes për tu licencuar si noter dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit 30 ditor për paraqitjen e kërkesës harton listën e cila duhet të përmbajë emrat e zëvendësnoterëve që shprehin interesin për t'u



licencuar si noter. Lista duhet të jetë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

16. Në rastin e zëvendësnoterëve që aplikojnë për marrjen e licencës si noter dhe që plotësojnë kriteret ligjore, fitues shpallet kandidati me vjetërsi më të madhe në profesion.
17. Në rastin e zëvendësnoterëve me vjetërsi pune të barabartë, licenca i jepet aplikuesit me më shumë pikë në provimin e kualifikimit.
18. Në rastin e zëvendësnoterëve që aplikojnë për marrjen e licencës si noter, që plotësojnë kriteret ligjore, kanë të njëjtën vjetërsi pune në profesion, dhe pikë të barabarta në provimin e kualifikimit, fitues shpallet kandidati që ka vendbanimin apo që vendbanimi i të cilit ndodhet më pranë bashkisë ku është evidentuar vendi vakant.
19. Ministri i Drejtësisë urdhëron dhënien e licencës zëvendësnoterit brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit, nëse plotësohet kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”.
20. Zëvendësnoterët që nuk përmbushin kushtet dhe kriteret ligjore për transferimin e veprimtarisë noteriale, informohen në adresën postare nga Ministria e Drejtësisë mbi arsyet e refuzimit.
21. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë, zëvendësnoteri ka të drejtë ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
22. Në rast se nuk paraqiten shprehje interesi nga zëvendësnoter, Ministri i Drejtësisë brenda 20 ditëve mund të i kërkojë zëvendësnoterit me vjetërsinë më të madhe në profesion që plotëson kushtet dhe që ushtron funksionin brenda zonës ku shtrin kompetencën e saj tokësore gjykata e apelit të juridiksionit të zakonshëm, të aplikojë për një vend vakant që nuk është plotësuar dhe në rast refuzimi procedohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.
23. Në rast se zëvendësnoteri i përgjigjet thirrjes për shprehje interesi, duke aplikuar për një vend vakant dhe plotëson kriteret ligjore, Ministri i Drejtësisë urdhëron dhënien e licencës zëvendësnoterit brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e shprehjes së interesit.
24. Për zëvendësnoterët që refuzojnë aplikimin në një nga vendet vakante, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë harton një listë e cila nënshkruhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.
25. Ministria e Drejtësisë i përcjell Dhomës Kombëtare të Noterisë listën e zëvendësnoterëve që përjashtohen nga e drejta për shprehje interesi për një vend vakant si noter për një periudhë 2-vjeçare.



26. Shtetasi i pajisur me licencën e ushtrimit të profesionit të noterit nga Ministri i Drejtësisë fillon ushtrimin e veprimtarisë noteriale në vendin e shpallur vakant jo më vonë se 60 ditë nga data e lëshimit të licencës. Me kalimin e këtij afati, sipas njoftimit nga Dhoma Kombëtare e Noterisë ose nga vetë i interesuari, licenca e ushtrimit të shërbimit të noterisë shfuqizohet dhe Ministri i Drejtësisë, në bazë të renditjes së aplikantëve në listën e pritjes, emëron një aplikant tjetër në atë pozicion.
27. Në rast se edhe ky i fundit nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë së tij noteriale brenda afatit 60-ditor, zhvillohet një garë e re për të plotësuar vendin vakant.
28. Kandidati që pas emërimit nuk fillon aktivitetin, mund të pezullohet nga shprehja e interesit me vendim të Këshillit të Dhomës për një periudhë prej një deri në pesë vjet.
29. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë.
30. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SAJTI)


